


NDRIÇO TË ARDHMEN TËNDE



DEMOKRACIA NË KOSOVË

ERMIRA (12), VESA (12), RINA (12), GETUAR (13), FLORIAN (12)



Pse është e rëndësishme të jetojmë me parimet e demokracisë? A duhet kontributi ynë që ta forcojmë demokracinë? Për këto dhe shumë informata të tjera lexoni artikullin tonë

Që të gjithë të jetojmë të lumtur, të barabartë, në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin duhet ti zbatojmë parimet e demokracisë. Demokracia, është dëshmuar se është sistemi më adekuat i qeverisjes, sepse populli e ka fjalën kryesore dhe merr vendimet më të rëndësishme për shtetin e tij.

Kur themi parimet e demokracisë në këto parime përfshihen: shprehja e lirë e mendimit, liria, pajja, solidariteti, respekti, barazia, toleranca etj. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Për dallim nga atëherë, sot zbatohen shumë më shumë parimet e lart cekura, por presim që çdo qytetar ti zbatoj me përpikmëri ato.

Dy llojet më të njohura të demokracisë janë: demo-

kracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet edhe në dy sisteme të tjera: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Shteti ynë Kosova, ka demokraci përfaqësuese parlamentare, që i bie se populli i zgjedh përfaqësuesit të cilët do ti përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Përfaqësuesit e popullit janë deputetët, të cilët duhet ta mbështesin popullin gjithmonë. Por, edhe populli duhet që të jetë mendje hapur dhe të jetë aktiv në marrjen e iniciativave të duhura. Pra, kërkohet nga të gjithë ne që të kontribuojmë në përforcimin dhe zbatimin e parimeve të demokracisë. Ndryshimin mund ta bëjmë ne, vetëm me punë dhe me përkushtim. Prandaj, ju ftojme edhe juve qytetarë të dashur, që të na ndihmoni në ndërtimin e mëtutjeshëm të demokracisë. Mendo sa më shumë edhe për të tjerët, sepse vetëm kështu do të mund të kemi një të ardhme edhe më të ndritur.



Në demokraci të gjithë e kemi të drejtën e votës



Autorët e artikullit

ARDHMËRIA E SHTETIT TONË

DRILONA (13), BENJAMIN (12), RINA (12), BENJADIN (12)


Ne jemi fëmijë të shkollës „Emin Duraku“ dhe ne jemi gazetarë të rinjë. Ne në këtë artikull dëshirojmë të paraqesim disa fjali për qytetarinë aktive

Demokracia rrjedh nga gjuha greke që do të thotë populli udhëheqë. Ne e udhëheqim vendin tonë përmes votave që qytetarët kanë të drejtën e saj në moshën 18 vjeçare. Gjithashtu qytetari aktiv ka të drejtë të nënshkruaj peticione dhe të marrë pjesë në tubime publike. Mirëpo ne fëmijët, të cilët jemi nën moshën 18 vjeçare kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e përkujdesjes ndaj familjes tonë dhe të drejtën për të jetuar në mjedis të pastër.

Për të pasur një ambient të pastër ne na duhet ta ruajmë ambientin duke hedhur mbeturina në shportën e caktuar. Kjo është qytetaria aktive. Për një të ardhme më të mirë, ne qytetarëve na duhet që ta ruajmë vendin tonë dhe ne fëmijët duhet të kemi dituri, sjellje dhe edukim të mirë.



Kuptimi i fjalës demokraci



Duke votuar ne ndryshojmë të ardhmen



Nënshkruajmë peticione për çështje të ndryshme



Ne mbrojmë ambientin

Sot kemi mësuar shumë gjëra



Fëmijët gazetarë



VENDI KU PUNOJNË PËRFAQËSUESIT TANË

LULZIM (14), IDILA (12), AITOR (12), VALBONA (15), LEONITA (12)

Në Kosovë ka shumë institucione të rëndësishme, e njëri prej tyre është Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku aty përfaqësuesit tanë i miratojnë ligjet

Kosova është vend demokratik i cili ka institucione që funksionojnë në mënyrë demokratike. Institucioni më i lartë shtetëror në Kosovë është Kuvendi.

Kuvendi është institucion prej të cilit dalin ligjet, e këto ligje janë rregulla të shkruara në Kushtetutën e Kosovës dhe duhet që qytetarët e Kosovës t'iu përmbahen atyre.

Në qytetarët e Republikës së Kosovës, i zgjedhim deputetët të cilët na përfaqësojnë neve në Kuvend. Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë të cilët na përfaqësojnë neve dhe interesat tona, ku 20 vende prej 120 janë të rezervuara për komunitetet jo shumicë e ato janë: komuniteti ashkali, romë, boshnjak, turk, egjiptian dhe serb.

Kuvendi i Kosovës ka disa funksione shumë të rëndësishme e ato janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe ai i kontrollit.

Në Kuvend kemi 3 lloje të votimit: i hapur (me dorë), elektronik dhe me shkrim (i fshehur). Gjithashtu, në mënyrë të ngjashme të votimit sikurse në Kuvend, e kemi bërë edhe në klasë ku kemi votuar në mënyrë të hapur për kryetaren e klasës.

Pra, nga e gjithë kjo çka ne sot kemi mësuar në grup, kemi kuptuar se ne jemi ata të cilët marrim vendime për shtetin tonë, por përmes përfaqësuesve tanë të cilët i zgjedhim ne.


Jemi shumë të lumtur që sot, kishim mundësinë të jemi pjesë e projektit „Demos-ti“, ku kemi mësuar shumë gjëra që na duhen në jetë.




Autorët e artikullit



Nxënësit e klasës sonë duke votuar kryetaren e klasës



Vendi ku miratohen ligjet



Akti më i lartë shtetëror - Kushtetuta



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Emin Duraku“
Klasa: 7/3
Vendi: Prishtinë